

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Yvendoret/ Rama rikonfirmon si kandidatë 44 kryebashkiakët aktualë! Lefter Alla zëvendësohet nga kryetarja e PS në Bulqizë! Risi në Vlorë, Divjakë dhe Has (LISTA E PLOTË)



Tiranë/ I riu që ktheu motrat në narkomane, shpallet në kërkim një 40-vjeçar! I lidhur me të dyja, u jepte kokainë



Luiz Ejlli 'dorëzon' Kiarën, zgjedh banorin që do të marrë me vete në finale! Nuk e çova dot të dashurën time



Rama: Mbrerëria e Bashkuar i jep 4 mld euro Shqipërisë, në dispozicion për projektet strategjike



Miratohen listat e kandidatëve për këshilltarë bashkiakë të koalicionit opozitar në 61 bashki! Berisha merr 'pjesën e luanit', 240 pozicione për Metën

Kronikë

Parandalohet vjedhja me armë në Lushnjë, 3 në kërkim! Rrezikuan jetën e efektivëve të policisë kur u arratisën

Në Lushnjë tre të rinj janë shpallur në kërkim nga policia pasi kishin planifikuar që të kryenin grabitje me armë, ndërsa në përpjekje për tu larguar rrezikuan jetën e efektivëve të policisë. Policia ka shpallur në kërkim shtetasit Renato Çala, 30-vjeç, Florenc Tatoshi, 36-vjeç, dhe Bukurosh Mukja, 66 vjeç, të tre banues në Elbasan



Foto: Ilustruese



Redaksia
25 Mars, 10:49 | Përditësimi: 25 Mars, 11:15



Në Lushnjë tre të rinj janë shpallur në kërkim nga policia pasi kishin planifikuar që të kryenin grabitje me armë, ndërsa në përpjekje për tu larguar rrezikuan jetën e efektivëve të policisë. Policia ka shpallur në kërkim shtetasit Renato Çala, 30-vjeç, Florenc Tatoshi, 36-vjeç, dhe Bukurosh Mukja, 66 vjeç, të tre banues në Elbasan.

Siç njoftojnë blutë e Lushnjë, në vendin e quajtur "Rotondo e Çermës", efektivët lokalizuan makinën e cila dyshohet se do të kryente grabitje dhe i kanë bërë shenjë për të ndaluar. Por drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të policisë për të ndaluar dhe ka shtuar shpejtësinë duke rrezikuar jetën e efektivëve që ishin në rrugë, për të ndaluar këtë automjet.



LEXO EDHE: Publikohen emrat e kandidatëve për 6 bashkitë e Fierit, PS u beson 4 prej kryebashkiakëve aktualë



Policia i është vënë në ndjekje të makinës tip "Benz" i cili po lëvizte me shumë shpejtësi në drejtim të fshatrave të Peqinit.

Për shkak të shpejtësisë së madhe, automjeti ka dalë nga rruga dhe tre shtetasit që udhëtonin në automjet e kanë braktisur atë dhe kanë mundur të largohen, duke përfutur nga errësira. Gjatë kontrollit të automjetit, policia gjeti dhe sekuestroi një sasi municioni luftarak.

Në kuadër të operacionit "Parandalimi" u identifikuan tre shtetasit që qarkullonin në automjetin me targa të falsifikuara dhe bënë shpalljen e tyre në kërkim, për veprat penale "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" dhe "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve".

Vijon puna për kapjen e 3 shtetasve të shpallur në kërkim, si dhe për dokumentimin e disa vjedhjeve të kryera nga këta shtetas, në rrethin Lushnjë.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për veprime të mëtejshme.

M.Q./S.L.E./Shqiptarja.com

TAG: grabitje Lushnje Fier

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Debat i në PD, a duhet të kenë kandidatë në 61 bashki më 14 maj?

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera



110 vite nga masakra serbe, memorial përkujtimor në Gjuza të Lushnjës! Historiani: Pse në librat e shkollës nuk ka asnjë rresht për këtë ngjarje?

25 Mars, 19:33



Lëvizte i armatosur me automatik, arrestohet 20-vjeçari në Fier

25 Mars, 13:10



Dhunë policit, arrestohet 47-vjeçari në Fier! Në Mallakastër një 49-vjeçar shkeli masën 'arrest shtëpie' dhe prangoset në lokal

24 Mars, 17:19



Inceneratori i Fierit, GJKKO vendos kalimin për gjykim të dosjes! Të akuzuar Lefter Koka, Alqi Bllako dhe 8 të tjerë

24 Mars, 11:39



I dehur në timon, nuk i ndalon efektivëve dhe largohet me shpejtësi duke iu rrezikuar jetën, arrestohet 42-vjeçari në Lushnjë

23 Mars, 10:16



Prej 1 muaji punonte në një firmë, spanjollit 47-vjeçar u gjet i vdekur në tualetin e hotelit në Divjakë! Shoku raportoi 'vetëvrasjen'

22 Mars, 08:43



Pamjet nga aksidenti ku humbi jetën efektiv i policisë në Patos! VIDEO nga mjetet e bëra copash! Arrestohet shoferi

20 Mars, 09:33



Aksident me vdekje në Patos, përplasen dy automjete, humb jetën efektiv i policisë

19 Mars, 22:43



Aksident gjatë orëve të natës në Fier, dy 'benz'-at përplasen 'kokë më kokë! Plagoset një person

18 Mars, 07:15



Arrestimi i kryebashkiakut të Bulqizës, Berisha: Narkomanit i nxorën dosjen sepse nuk largohej, donte të kandidonte prapë në 14 maj

16 Mars, 19:35



Ndërtimi i varrezave, banorët kundër bashkisë Lushnjë: Terreni është argjilor, toka e papërshtatshme! Peticion me 100 firma për Avokatin e Popullit e prefektin



Yrjet Saliassi

16 Mars, 17:46



Fier/ Piktori Gazmend Leka çel ekspozitën 'Kalo i një grua': Linjë ekologjike e shpirtit

16 Mars, 17:33